



Prishtinë: 29.12.2010

Kodi i ZRRE-së: V_329_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_502_12_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_502_12_10**;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 28.12.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2010 nxori këtë:

VENDIM

Refuzohet apelimi i e konsumatorit Sabit Gashi nga fshati Mramor si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së me datë 26.07.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 01.07.2010, lidhur me kontestimin për parapagimin për RTK.

- Me datë 30.06.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar parapagimin për RTK.
Provë: Dëftesa e ankesës në KEK
- Me datë 01.07.2010 Departamenti për Konsumatorë iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar e duke u thirrur në Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës nr. 02/L-47.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 01.07.2010
- Me datë 26.07.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.
- Me datë 09.12.2010 DMK në ZRRE ka lëshuar vendimin **ZRRE/DMK_V_502_12_10** me të cilin ka refuzuar ankesën e konsumatorit.
Provë: Vendimi ZRRE/DMK_V_502_10_10 i datës 09.12.2010

- Me datë 28.12.2010 konsumatori ka apeluar vendimin e DMK-së **ZRRE/DMK_V_502_12_10** të datës 09.12.2010.
Provë: Ankesa (apelimi) i konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_502_12_10** dhe ka vendosur që të **refuzojë** apelimin e konsumatorit për arsye se konsumatori nuk ka sjell asnjë dëshmi në DMK të ZRRE-së që do të plotësonte kriteret e paraqitura në nenin 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar